



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 28.07.2008, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e Komisionit**

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Ibrahim Selmanaj, Berat Luzha, Selvie Halimi, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Zef Morina dhe Heset Cakolli.

**Munguan** : Zylfi Merxha, Elheme Hetemi dhe Ali Lajçi.

**Pjesëmarrës nga OSBE-ja**: Blerim Vela

**Përfaqësuesit nga ministria**: Fadil Musa, Adem Arifaj dhe Isah Rudaku

**Nga stafi mbështetës i komisionit** : Lule Ymeri, Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikiht,**
- 3. Të ndryshme.**

**Kryesuesi i komisionit** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.**

Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 21.07.2008, pa vërejtje.

**2. Shqyrtimi i Projektligjit për Organizmat e Modifikuar Gjenetikiht**

**Kryesuesi**, theksoi se nga takimi i fundit Komisioni ka kërkuar nga përfaqësuesit e Ministrisë dhe dekani i Fakultetit të Bujqësisë sqarime lidhur me disa nene konkrete.

Dekani i Fakultetit të Bujqësisë ka ofruar një material lidhur me këtë projektligj i cili nga Komisioni konsiderohet si i vonuar, dhe si i tillë pasi kishte të bëjë me vërejtje teknike gjuhësore nuk u shqyrtua nga Komisioni.

Përfaqësuesit e Ministrisë i kanë proceduar me kohë Komisionit propozimet dhe sugjerimet e veta lidhur me projektligjin.

Komisioni shqyrtoi propozimet Ministrisë së Bujqësisë lidhur me këtë projektligj, dhe propozoi këto amendamente:

#### **Amendamenti 1**

Preambula riformulohet:

**“Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

**Në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të rregullimit ligjor të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe të mjedisit,**

**Miraton:**

**Ligjin për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht”.**

#### **Amendamenti 2**

Neni 2.2. riformulohet:

**”Autoriteti kompetent nënkupton njësinë organizative brenda Ministrisë e cila është në kuadër të Departamentit të Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe merret me çështjet lidhur me OMGJ-të”.**

Neni 2.9. fjala : **“aprovuara”** zëvendësohet me fjalën: **“aprovuar”**

#### **Amendamenti 3**

Neni 4.4. riformulohet:

**”Ministria me akt nënljgjor e përcakton fushë veprimtarinë e Autoritetit Kompetent”.**

Neni 4.5. fjala: **“vendosjes”** zëvendësohet me fjalën: **“vendosjen”.**

#### **Amendamenti 4**

Neni 6.2. pika 8. fshihet fjala: **“me”.**

#### **Amendamenti 5**

Neni 15.4.

Fjala: **“progjeneve”** zëvendësohet me fjalën: **“pasardhësve”**

#### **Amendamenti 6**

Neni 30.2. fjala: **“Komisioneve”** zëvendësohet me fjalën: **” Këshillave”.**

#### **Amendamenti 7**

Neni 39 riformulohet:

**” Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ( 15) ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”.**

**Jakup Krasniqi**  
**Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**

Amendamentet e propozuara u miratuan nga të gjithë anëtarët e pranishëm të Komisionit.

### 3. Të ndryshme

**Kryesuesi** lidhur me këtë pikë fjalën ia dha përfaqësuesit nga OSBE-ja që të njoftoi rreth vizitave të Komisionit në Kroaci dhe në Hungari.

Përfaqësuesi nga OSBE, Blerim Vela i njoftoi shkurtimisht anëtarët e Komisionit me vizitat që do të realizohen në Institucionet relevante në Kroaci dhe në Hungari gjatë muajit shtator dhe tetor të këtij viti.

Më pas ai sqaroi se Komisioni do të udhëtoi në përbërje prej gjashtë anëtarësh në Kroaci dhe kjo vizitë do të përqëndrohet më tepër në fushën e mjedisit.

Ndërsa vizita e planifikuar për Hungari do të realizohet gjatë muajit tetor gjithashtu në përberje prej gjashtë anëtarëve të Komisionit dhe do të përqëndrohet për fushën e bujqësisë.

Komisioni vendosi që emrat e anëtarëve të Komisionit që do të udhëtojnë në Kroaci janë:

1. Lulzim Zeneli, kryetar i Komisionit,
2. Ibrahim Selmanaj, anëtarë
3. Selvije Halimi, anëtare
4. Zef Morina, anëtar
5. Kosara Nikoliq, anëtare dhe
6. Ali Lajçi, anëtar.

Emrat e anëtarëve të Komisionit që do të udhëtojnë në Hungari janë:

1. Lulzim Zeneli, kryetar i Komisionit,
2. Zylfi Merxha, anëtar
3. Myrvete Pantina, anëtare
4. Berat Luzha, anëtar
5. Elheme Hetemi, anëtare dhe
6. Hesel Cakolli, anëtar.

Përfaqësuesi nga OSBE, Blerim Vela në vazhdim i propozoi Komisionit që të përgatisë një plan të punës për periudhën e ardhshme katër mujore.

Berat Luzha shtroi çështjen e Projektligjit për shitjen e banesave dhe kërkoi sqarim lidhur me vonesën e procedimin e tij në Kuvend.

Kosoara Nikoliq si anëtare e Komisionit për të drejta dhe interesa të komuniteteve, lidhur me këtë Projektligj i njoftoi anëtarët e Komisionit se Projektligjit për shitjen e banesave është në procedurë të amendamentimit dhe shqyrtimit nga Komisioni për të drejta dhe interesa të komuniteteve me qëllim që të mos dëmtohen palët.

Kryesuesi i Komisionit në fund kërkoi nga administrata që materialet nga dëgjimet publike të Komisionit lidhur me projektligjin mbi parandalimin e ndotjes së natyrës dhe projektligjin për mbrojtjen e mjedisit t'i shpërndahen anëtarëve të Komisionit me qëllim të përgatitjes për shqyrtimin dhe amendamentimin e tyre për mbledhjen e radhës e cila do të mbahet në fillim të muajit shtator.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50

**Përgatitur nga**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,  
Lulzim Zeneli**